



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ____/____/2017

V E N D I M

Nr. 152, datë 29.12. 2017

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, mbështetur në ligjin nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, mori në shqyrtim ankesën nr. 40, datë 13.04.2016, e Znj. N.K., ku pretendohet diskriminim për shkak të moshës, bindjes fetare dhe gjendjes ekonomike, nga ana e Znj. D.T., Drejtore e Qendrës Spitalore “Xhaferr Kongoli”, Elbasan.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

Ankuesja N.K., e datëlindjes 20.03.1960, ka punuar në pozicionin e sanitares pranë Qendrës Spitalore “Xhaferr Kongoli”, Elbasan, në Shërbimin e Patologjisë, për 12 vjet. Me shkresën nr. 167, datë 29.01.2016, të Drejtores së kësaj Qendre Spitalore, ajo është njoftuar për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës, duke filluar nga data 30.04.2016.

Së pari, në ankesën e saj znj. N.K. ka ngritur pretendimin se shkak kryesor për largimin e saj nga puna, ka qënë mosha. Ajo është 56 vjeç dhe sipas shpjegimeve të dhëna, Spitali ku ka punuar ka mbajtur në punë vetëm sanitaret në moshë më të re.

Së dyti, Znj. N.K. pretendon se bindjet e saj fetare¹ janë bërë shkak për diskriminim, pasi është praktikante e besimit “Dëshmitarët e Jehovait” dhe për këtë arsye nuk është parë me preferencë nga drejtuesja e institucionit mjekësor.

¹ Në vijim të shqyrtimit të ankesës, Znj. N.K. ka hequr dorë nga shkak i diskriminimit “bindje fetare”.

Së treti, ajo shpjegon se gjendja e vështirë ekonomike, si nënë e katër fëmijëve me një bashkëshort invalid (i sëmurë mendor prej 12 vjetësh), kanë ndikuar në indiferencën dhe mospërkrahjen e saj nga Drejtuesja e Qendrës Spitalore, Znj. D.T. Sipas saj, i vetmi mjet jetese për familjen është pensioni i invaliditetit të bashkëshortit.

Sa më sipër, pas analizimit të ankesës së Znj. N.K., u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33, pika 3 të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

Për këtë arsye, strukturat përkatëse të Komisionerit filluan procedurat për shqyrtimin e saj, si më poshtë:

1. Mbështetur në nenin 33, pika 7, të Ligjit nr. 10 221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”², me shkresë nr. 437/1 prot, datë 18.04.2016, Komisioneri iu drejtua për informacion shtesë ankueses znj. N.K.. Referuar pretendimeve të saj, iu kërkuar që të depozitonte fakte dhe prova konkrete, që lidhin trajtimin e pabarabartë dhe disfavorizues, nga Qendra Spitalore “Xhaferr Kongoli”, Elbasan, në krahasim me punonjës të tjerë të kësaj qendre spitalore, të cilët ndodhen në kushte të njëjta apo të ngjashme.

- Në përgjigje të shkresës nr. 437/1 prot, datë 18.04.2016, të Komisionerit, ankuesja N.K. ka depozituar në cilësinë e provës, aktet e mëposhtëme:

- Shkresën nr. 167 prot, datë 29.01.2016 të Ministrisë së Shëndetësisë, ku i komunikohet ndërprera e marrëdhënieve të punës, me datë 30.04.2016³;
- Vërtetim nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, konkretisht KMCAP, nr. 1753, datë 12.04.2016, për Z. A. K., bashkëshort i ankueses, i cili plotëson kushtet për të fituar të ardhura për invaliditet të plotë, nga data 10.05.2016-30-04.2017;
- Mandat pagese nga Posta Shqiptare, ku provohet se përfitimi financiar për invaliditet të plotë është 15.019 lekë;
- Çertifikatë familjare, nga ku rezulton se familja është e përbërë nga 6 anëtarë, përkatësisht kryefamiljari, bashkëshortja dhe katër fëmijë.

2. Me shkresën nr. 437/2, datë 26.04.2016, Komisioneri iu drejtua me kërkesë për informacion Znj. D.T., Drejtore e Qendrës Spitalore “Xhaferr Kongoli”, Elbasan, duke i vënë në dispozicion aktet respektive: Struktura organike aktuale dhe e mëparshme e Qendrës Spitalore “Xhaferr Kongoli”, Elbasan; Informacion mbi numrin e punonjësve të larguar nga puna, me të njëjtin motivacion me znj. N.K.; Lista e punonjësve dhe pozicionet e punës që janë suprimuar me miratimin e strukturës së re; Numri i pozicioneve të sanitareve, referuar strukturës së mëparshme

²Neni 33, pika 7, i ligjit 10 221/2010, parashikon: “Me marrjen e ankesës, komisioneri verifikon faktet. Për këtë qëllim, komisioneri mund t’u kërkojë ankuesit dhe personit kundër të cilit është drejtuar ankesa, të paraqesin parashtrime me shkrim brenda 30 ditëve nga dita që palët marrin njoftimin. Kur e çmon të nevojshme, komisioneri merr informacione dhe nga çdo person ose burim tjetër”.

³ Në shkresë nuk jepet asnjë shkak apo sqarim tjetër pse është vendosur ndërprerja e marrëdhënieve të punës, znj. N.K..

dhe aktuale të Qendrës Spitalore “Xhaferr Kongoli”; Informacion mbi kriteret e ndjekura për përzgjedhjen e punonjësve, që në kuadër të ristrukturimit, janë larguar nga puna.

- Në përgjigje të shkresës nr. 437/2, datë 26.04.2016, të Komisionerit, Qendra Spitalore “Xhaferr Kongoli”, Elbasan ka bërë me dije, se Znj. N.K. nuk është larguar nga puna për shkak të gjendjes arsimore, bindjes fetare dhe gjendjes ekonomike, por mbi bazën e kriterëve të përcaktuara në shkresën nr 261, datë 18.01.2016, të Ministrit të Shëndetësisë për “Strukturën analitike të Shërbimit Spitalor Elbasan”⁴. Sipas shpjegimeve të dhëna prej tyre, “Znj. N.K. është vlerësuar me 7 pikë për performancën e punës së saj”⁵.

3. Në vijim të procedurave hetimore, në zbatim të Urdhërit nr. 93, datë 24.05.2016, të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Inspektorët e Komisionerit, u paraqitën për për hetim dhe verifikim të pretendimeve të ankueses në Qendrën Spitalore “Xhaferr Kongoli” Elbasan, me objekt administrimin e akteve lidhur me:

- Moshën e të gjitha sanitarëve të larguara nga puna në kuadër të ristrukturimit të kësaj qendre spitalore;
- Moshën e të gjitha sanitarëve të mbetura në punë pas zbatimit të strukturës së re;
- Masat disiplinore (nëse ka) për ankuesen N.K.;
- Mënyrën se si është përcaktuar pikëzimi, lidhur me kriterin e disiplinës në punë, për sanitarët e larguara nga puna;
- Vlerësimet në punë të ankueses për vitet pararendës;
- Listën e sanitarëve të mbetura në punë pas ristrukturimit, si dhe tabelës së pikëavarazhit, mbi bazën e së cilës ato janë vlerësuar.

- Inspektorët e Komisionerit u takuan me Përgjegjësen e Sektorit të Burimeve Njerëzore, Znj. B. D., e cila informoi se Znj. N.K. ka filluar punë pranë Qendrës Spitalore “Xhaferr Kongoli”, në Elbasan, më datë 01.07.2004, në pozicionin e sanitarës, pranë Shërbimit të Pathologjisë. Znj. B.D. hodhi poshtë pretendimet e Znj. N.K., mbi çështjen e ndërprerjes së marrëdhënieve të punës dhe diskriminimit për shkak të moshës, gjendjes ekonomike dhe bindjeve fetare. Ajo ka theksuar faktin se vetëm është zbatuar struktura e re e institucionit, miratuar nga Ministri i Shëndetësisë. Sipas saj, nga 25 sanitarë që punonin pranë këtij shërbimi, 15 prej tyre janë larguar, si pasojë e suprimimit të pozicionit të punës. E pyetur, nëse institucioni ka dhënë ndonjë masë disiplinore për ankuesen, Znj. B.D. ka konfirmuar se “Znj. N.K. asnjëherë nuk i është dhënë masë disiplinore”. Sipas pohimeve të saj, “Znj. N.K. ka filluar punë pranë Qendrës Spitalore “Xhaferr Kongoli”, Elbasan, më 01.07.2004 dhe asnjëherë nuk është vlerësuar negativisht dhe as është marrë masë disiplinore”.

- Lidhur me pretendimin e ankueses se është diskriminuar nga institucioni për shkak të bindjeve fetare, pasi është praktikante e “Dëshmitarëve të Jehovahit”, Znj. B.D. është shprehur se

⁴ Përmes shkresës 414/2 prot, datë 18.04.2016 dhe 437/2 prot, datë 26.04.2016.

⁵ Shkresës nr. 1318/1, datë 28.07.2016 e Qendrës Spitalore “Xhaferr Kongoli”, Elbasan.

“Drejtuesit e Qendrës Spitalore nuk kanë dijeni lidhur me këtë fakt, ndaj nuk ka si të jetë diskriminuar prej institucionit”.

- E pyetur në lidhje me pretendimin e diskriminimit të ankueses për shkak të “gjendjes ekonomike”, Znj. B.D. u shpreh se nuk ka dijeni mbi situatën ekonomike të ankueses, por theksoi shprehimisht faktin se: “në tërësi sanitaret kanë gjendje jo të mirë ekonomike”.

4. Në vijim të procedurave hetimore, nëpërmjet shkresës nr. 685, datë 04.07.2016, palët u njoftuan për seancën dëgjimore për të parashtruar dhe argumentuar në mënyrë të drejtëpërdrejtë pretendimet e tyre. Seanca u zhvillua më datën 13.07.2016, pranë Zyrës së Komisionerit.

- Nga proçeverbali i seances dëgjimore rezulton se u paraqit ankuesja N.K., ndërsa Spitali i Elbasanit u përfaqësua nga Znj. B. D., Përgjegjëse e Sektorit të Burimeve Njerëzore.
- Ankuesja N.K. prashtroi pretendimet e saj për diskriminim për shkak të moshës dhe gjendjes ekonomike, ndërkohë që tërhoqi pretendimin e diskriminimit për shkak të bindjeve fetare.

Ajo theksoi se gjatë 12 viteve të punës pranë Qendrës Spitalore “Xhaferr Kongoli”, Elbasan, asnjëherë nuk është vlerësuar negativisht, përkundrazi Kryeinfermierja e Shërbimit të Pathologjisë e ka vlerësuar gjithmonë si më të mirën ndër sanitaret që punonin në këtë spital. Sipas saj, vlerësimet në punë janë mbajtur gjithmonë nga Kryeinfermierja, por në muajin mars ato janë asgjësuar. Lidhur me këtë pohim të Znj. N.K., përfaqësuesja e Spitalit të Elbasanit nuk dha asnjë sqarim dhe nuk paraqiti asnjë fakt kundërshtues edhe pse iu bë e qartë se barra e provës, në bazë të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, binte mbi Spitalin e Elbasanit.

- Të pyetur nga Komisioneri, lidhur me mospërputhjen mes vlerësimit në punë të ankueses, duke patur parasysh se ndaj saj nuk është marrë asnjëherë masë disiplinore dhe pikëzimit të vendosur për kriteret e performancës dhe disiplinës, përfaqësuesja e Spitalit të Elbasanit u shpreh se nuk ka dijeni lidhur me këtë fakt.
- Lidhur me pretendimin e ankueses se në punë janë mbajtur sanitare më të reja në moshë se ajo, Znj. Dervishi nuk dha përgjigje. Përsa i përket gjendjes së rënduar ekonomike të ankueses, ajo u shpreh se *“Zyra e Burimeve Njerëzore nuk mban evidenca mbi gjendjen ekonomike të personelit, por në tërësi të gjitha sanitaret janë në gjendje jo të mirë ekonomike”.* Ankuesja N.K. i ka hedhur poshtë argumentat e Znj. Dervishi, me pretendimin se për gjendjen e saj të rënduar ekonomike dhe gjendjen shëndetësore të bashkëshortit të saj, ka vënë vazhdimisht në dijeni Kryeinfermierin e Shërbimit të Pathologjisë.

Sa më sipër, gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në konsideratë vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji nr.10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.

Mbështetur në provat dhe faktet e administruara gjatë procesit të shqyrtimit administrativ, të ankesës nr. 40, datë 13.04.2016, të Znj. N.K., Komisioneri vlerëson:

Ligji 10 221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi” siguron mbrojtjen nga diskriminimi për një listë joshtruese shkaqesh, ku ndër to është edhe “mosha” e “gjendja ekonomike”⁶.

Referuar gërmave a), b) dhe c), të pikës 1, të nenit 12, të Kapitullit II “Mbrojtja nga diskriminimi në punësim”, të ligjit të sipërpërmendur, parashikohet shprehimisht:

“1. Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me:

a) shpalljen e vendeve të lira të punës;

b) rekrutimin dhe përzgjedhjen e punëmarrësve;

c) trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimin, përfitimet dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës”.

Për sa më sipër, mbështetur në provat dhe pohimet e palëve, nga Spitali i Elbasanit është konfirmuar fakti, se Znj. N.K. nuk është vlerësuar asnjëherë negativisht përgjatë 12 viteve të punës pranë Qendrës Spitalore “Xhaferr Kongoli”, Elbasan. Ndërkohë, referuar tabelës së pikëavarazhit të Shërbimit të Pathologjisë, ndaj saj është dhënë një vlerësim pikëzimi si më poshtë:

- 10 pikë për arsimin;
- 7 pikë për performancë;
- 7 pikë për disiplinën.⁷

Në total, ankuesja është vlerësuar me 24 pikë, nga 25 pikë që ka qenë pragu i kalimit për të qendruar në punë.

Mbështetur në aktet shkresore të depozituara nga Spitali i Elbasanit dhe në informacionin e dhënë prej tyre, nuk sqarohet se mbi cilën referencë apo kriter, Drejtoria e Spitalit ka kryer vlerësimin për performancën dhe disiplinën ndër vite, pasi nuk disponon asnjë dokument që të provojë objektivitetin e vlerësimit të ankueses N.K., gjatë 12 viteve në punë në këtë institucion.

⁶ Neni 1 “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

⁷ Sipas kësaj tablele 10 pika i korrespondojnë vlerësimit shumë mirë, 7 pikë, mirë dhe 5 pikë mjaftueshëm.

Evidentohet qartë fakti, se ankuesja është vlerësuar me 10 pikë në kriterin e arsimit, një kriter lehtësisht i provueshëm dhe i pakundërshtueshëm. Ndërkohë që, është detyrim i institucionit që vlerësimin për performancën dhe disiplinën ta bëjë mbi bazën e akteve të vlerësimit të administruara ndër vite, për të nxjerrë një mesatare reale, në total.

Për pasojë, Komisioneri gjykon se mesatarja e pikavarazhit të Znj. N.K. (24 pikë), e cila është nën marzhin e vlerësimit kalues⁸, nuk është e mbështetur në prova bindëse (akte shkresore). Vlerësimi është qartësisht subjektiv dhe i pabazuar ligjërisht.

Referuar akteve dhe procesverbalit të seancës dëgjimore, vihet re se nga 25 sanitare në Shërbimin e Pathologjisë, 15 prej tyre janë larguar për shkak të suprmimit të vendit të punës, duke mbetur në detyrë vetëm 10 prej tyre.

Nga tabela e vlerësimit me pikëzim, rezulton se Znj. N.K., e datëlindjes 23.03.1960, është larguar nga puna, ndërkohë pjesa më e madhe e sanitarëve, të lindura pas vitit 1960 janë mbajtur në punë. Më poshtë, pasqyrohet lista e sanitarëve, të lindura pas vitit 1960, që janë mbajtur në punë:

- M. K e datëlindjes 24.11.1990, vlerësuar me 30 pikë
- M.M e datëlindjes 30.08.1967, vlerësuar me 30 pikë
- P. G e datëlindjes 04.05.1967, vlerësuar me 30 pikë
- R. Z e datëlindjes 19.12.1965, vlerësuar me 30 pikë
- V. T e datëlindjes 30.03.1966, vlerësuar me 30 pikë
- N. F e datëlindjes 08.02.1966, vlerësuar me 25 pikë.

Nëpërmjet një analize krahasimore konstatohet se Znj. M. K e datëlindjes 24.11.1990, e moshës 26 vjeç është vlerësuar me 30 pikë. Po kështu, Znj. N. F, e datëlindjes 08.02.1966, është vlerësuar në total me 25 pikë, respektivisht 5 pikë në arsim; 10 pikë në performancë dhe 10 pikë në disiplinë.

Natyrshëm lind pyetja se mbi ç'baza është bërë vlerësimi i personave të sipërpërmendur nga Drejtoria e Spitalit? Si e provon Qendra Spitalore "Xhaferr Kongoli", se këto punonjëse e justifikojnë qëndrimin në punë, ndërsa Znj. N.K., e cila edhe pse ka 12 vjet punë pranë këtij institucioni, i ndërpriten marrëdhëniet e punës për shkak të performancës së ulët?

Ndërkohë që, lidhur me performancën në punë nuk ka asnjë vlerësim, mbi të cilin të jenë përcaktuar pikët përkatëse për secilën punonjëse. Faktet lënë të dyshosh se përzgjedhja e punonjëseve, për të qëndruar në punë është bërë mbi baza preferenciale nga ana e drejtoreshës së Qendrës Spitalore, Znj. D.T..

⁸ Mbi bazën e kriterëve të vendosura, vlerësimi i punëmarrësit duhet t'i kalonte 24 pikët.

Për sa më sipër, mbështetur në nenin 7, pika 1, e ligjit 10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i cili shprehimisht parashikon: “Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim”, dhe në nenin 13, pika 1, gërma a) të po këtij ligji: “1. Punëdhënësi është i detyruar:a) të zbatojë, të mbrojë e të nxisë parimin e barazisë dhe të ndalimit të çdo lloj diskriminimi”, Komisioneri, vlerëson se ankuesja N.K. është ekspozuar ndaj trajtimit të padrejtë e të pabarabartë në raport me koleget e saj. Për pasojë, veprimet subjektive dhe preferenciale nga ana e drejtoreshës së Qendrës Spitalore, Znj. D.T., e kanë ekspozuar ankuesen kundrejt diskriminimit të drejtpërdrejtë, për shkak të moshës.

Mbështetur në nenin 37, pika 1, të ligjit 10 221/2010: “1. Vendimi i gjykatës cakton dëmshpërblim nëse gjykata vendos që ka shkelje të këtij ligji, duke përfshirë edhe një afat kohor për kryerjen e zhdëmtimit” dhe nenin 38 të po këtij ligji: “Dëmshpërblimi përfshin, ndër të tjera, ndreqjen e shkeljeve ligjore dhe të pasojave të tyre përmes kthimit në gjendjen e mëparshme, kompensimin e duhur për dëmet pasurore si dhe jopasurore, ose përmes masave të tjera të përshtatshme”, Komisioneri rekomandon ankuesen N.K. t’i drejtohet Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë për të kërkuar dëmshpërblim.

-Lidhur me shkakun e diskriminimit “gjendja ekonomike”, pretenduar nga ankuesja, Komisioneri gjykon se:

Ankuesja N.K. pretendon diskriminim nga ana e Qendrës Spitalore “Xhaferr Kongoli”, edhe për shkak të gjendjes së vështirë ekonomike. Referuar certifikatës familjare, familja N.K. është e përbërë nga 6 anëtarë, respektivisht çifti i bashkëshortëve dhe 4 fëmijë. Nëpërmjet Vërtetimit të Institutit të Sigurimeve Shoqërore, konkretisht KMCAP, nr. 1753, datë 12.04.2016, provohet se Z. A. K., bashkëshort i ankueses, plotëson kushtet për të fituar të ardhura për invaliditet të plotë, nga data 10.05.2016-30-04.2017. Njëkohësisht, nëpërmjet mandat pagesës së marrë nga Posta Shqiptare, provohet se përfitimi financiar për invaliditet të plotë është 15.019 lekë.

Mbështetur në proçeverbalin e inspektimit dhe atë të seancës dëgjimore, rezulton se Qendra Spitalore “Xhaferr Kongoli”, Elbasan, nuk administron të dhëna rreth gjendjes social-ekonomike të punonjësve të saj. Znj. B.D., Përgjegjëse e Sektorit të Burimeve Njerëzore, është shprehur se: “në tërësi gjendja ekonomike e sanitareve është e dobët”, por kjo mbetet e paprovuar shkresërisht.

Për sa më sipër, mbështetur në nenin 7, pika 1 e ligjit 10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, për shkak të mungesës së provave dhe situatës krahasuese ndërmjet personave, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, Komisioneri vlerëson se nuk mund të shprehet, lidhur me pretendimin e ankueses N.K., për diskriminim për shkak të gjendjes

ekonomike, nga ana e Qendrës Spitalore “Xhaferr Kongoli”, Elbasan. Rezulton se nuk ka prova që të kenë analizuar dhe patur si kriter gjendjen ekonomike.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenet 1, 2 3, pikat 1 dhe 2, nenin 4, pika 1, nenin 7, pika 1, nenet 12, 13 e 15, nenin 21 pika 1, nenin 32, pika 1, gërma a), nenin 33, pikat 1, 3, 5, 7, 10 dhe 11 të Ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Konstatimin e diskriminimit të drejtpërdrejtë, për shkak të moshës të Znj. N.K., nga ana e Znj. D.T., Drejtore e Qendrës Spitalore “Xhaferr Kongoli”, Elbasan.
2. Marrjen e masave të menjëhershme, nga ana e Qendrës Spitalore “Xhaferr Kongoli”, Elbasan, për rikthimin në punë të Znj. N.K.
3. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijeni për këtë vendim, Qendra Spitalore “Xhaferr Kongoli”, Elbasan, të njoftojë Komisionerin, lidhur me masat e marra për zbatimin e këtij vendimi.
4. Mos zbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë, sipas parashikimeve të nenit 33, pika 11 dhe 13 të ligjit nr. 10 221, datë 04. 02. 2011 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.
5. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, brenda 45 ditëve, duke filluar ky afat nga dita e nesërme e komunikimit të këtij vendimi.

KOMISIONERI

IRMA BARAKU

Shkak – mosha
Fusha – punësim
Lloji i vendimit - diskriminim

